



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:184702
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706104

A.C.nr.7051/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Bujar Muzaqi, Kryetar, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit G.G., nga fshati N..., Komuna Kaçanik, të cilin e përfaqëson me autorizim N.I., avokat me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim K.E., nga Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, C.nr.534/20 datë 01.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, C.nr.534/20 datë 01.07.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, me aktgjykimin C.nr.534/20 datë 01.07.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“...I.MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit G.G., nga fshati N... Komuna Kaçanik a dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimit “K...”, me seli në Prishtinë, që paditësit të i’a paguaj shumën prej 857.45€ në emër të dëmit material për shpenzimet e shërimit.

Këtë shumë me kamatë prej 8% duke filluar nga data 21.12.2020 (data e paraqitje së padisë) e deri në pagesën definitive.

II. DETYROHET e paditura që paditësit të i’a paguaj shumën nga pika I e këtij dsipozitivi të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 394.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura K..., për shkak të: konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, dhe të priset aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë, ose të ndryshohet aktgjykimi dhe të hudhet në tersi si i pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi G.G., nga fshati N..., Komuna Kaçanik, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Komuna Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore, dëgjimit të palëve në procedurë, dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.534/20 datë 01.07.2021, me të cilin aktgjykim e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...Paditësi tek e paditura e ka marrë dhe e ka paguar policën për sigurimin e shëndetit në udhëtim, për vendet e pranuar në shengen në zonën C. Me këtë police paditësi ka udhëtuar në Gjermani. Gjatë qëndrimit në gjermani është sëmur dhe është derguar në spital për shërim. Me rastin e shërimit ka pësuar dam material sepse ka bër shpenzime për shërim, të cilat shpenzime janë të mbulushme nga polica e siuriumit të udhëtimit, vlera e shpenzimeve arrin në shumë prej 857.45€...”.*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të

procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike dhe atë se paditësi tek e paditura e ka marrë dhe paguar policën e sigurimit të shëndetit në udhëtim, fakt ky që vërtetohet në bazë të polisës së sigurimit me numër N.114125, se paditësi ka udhëtuar për në Gjermani ky fakt nuk ishte kontestues, se paditësi ishte sëmure gjatë qëndrimit në Gjermani ky fakt vërtetohet nga spitali Heilig –Geist në Bensheim, në repartin e Urologjisë ku ka bërë edhe ekzaminime mjekësore dhe atë nga data 01.09.2019 e deri më datën 02.09.2019, dhe se paditësi gjatë kësaj periudhe kohore ka bërë shpenzime të mjekimit dhe atë në shumën prej 857.45Euro, fakt që vërtetohet nga fatura që gjendet në shkresat e lëndës, dhe nga kjo rrjedhë edhe e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e demit për shpenzimet e mjekimit.

Ndërsa në nenin 136 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë decisive thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 450, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, nuk qëndronë pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kjashtë dhe arsyetimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës ankuese se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2020:184702
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706104

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.7051/2021 datë 20.05.2024

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi**